

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ATI21 sh.p.k.**

Ortaku themelues i Shoqërisë:

1. Znj. Borana Elbasani, lindur me 21/09/1989 ne Kruje, me banim në adresën Rruga Mustafa Matohiti, 1003. Tiranë, e identifikuar me karten e identitetit numer personal I95921010F,

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë 01 Mars 2021,

**VENDOSA**

**Neni 1**

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë tregtare ekonomike të emëruar “ATI21” sh.p.k..

**Neni 2**


Shoqëria do të jetë e formës së shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themelor.

**Neni 3**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Brigada 8”, Pallati “Teknoprojekt”, nr.7, Tiranë. Me vendim te administratorit ose personave të autorizuar prej tij, shoqëria mund të ndryshojë selinë si edhe të krijojë dhe suprimojë seli dytësore, agjensi, zyra dhe filiale edhe tjetërkund ndërkohë që për krijimin dhe suprimimin e tyre jashtë shtetit është e nevojshme vendimarrja e ortakeve me mbledhje të asamblesë.

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Megjithatë, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.



## Neni 5

Kapitali fillestar themelor i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) lekë. Ortaku Borana Elbasani zotëron një kuotë me vlerë 10.000 (dhjetemije) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyera dhe të nënshkruara nga ortakët themelues të shoqërisë.

## Neni 6

Shoqëria ka si objekt veprimtarite që vijojnë me poshte:

1. Dizenjim softëare-i, ku përfshihet analiza e kërkesave të sistemit softëare, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit softëare
2. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softëare, ku përfshihet programimi i sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që softëare-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike
3. Testim softëare, ku përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit softëare
4. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, ku përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN)
5. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, ku përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse
6. Zhvillim sistemesh migrimi, ku përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re
7. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike
8. Operim, menaxhim, suporti i përdorimit, trajnim dhe auditimi teknik/informatik për sistemet softëare.

## Neni 7

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit të saj.

## Neni 8

Administrator i shoqërisë do të jete znj. Borana Elbasani e identifikuar me kartën e identitetit numer personal I95921010F.

Modalitete për ndryshimin e administratorit si edhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe ligji 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”.

Ky Akt themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me originalin.

Datë 01 Mars 2021

ORTAKU THEMELUES

Znj. Borana Elbasani

Borana Elbasani  
